
INTERFAITH TOLERANCE ACCORDING TO THE QUR'AN AND PROPHETIC TRADITION

Abdulxhemil Nesimi

Faculty of Islamic Studies, Skopje, Macedonia abdulxhemil_nesimi@hotmail.com

Abstract: In the Qur'an and the biography of Prophet Muhammad there is no trace of any attitude that is in opposition to love, tolerance, or dialogue in the sense of striving with everyone.

In the last moments when Prophet Muhammad (pbuh) was dying, he said: *"I am leaving your covenant to Ahl as Kitab (the People of the Book, Christians and Jews)."*

Human and noble intentions and ideas are only those, which for the ultimate purpose have the common well-being and happiness of all people without distinction of race, nationality, and religion. These are differences born with man and there is nothing negative in them.

Being different from others is not a fault, sin or crime, and no one is responsible for this. Hatred, which stems from such differences, is one of the greatest disasters of humanity in history, from birth to race and racism.

People have been created different to get to know each other and not to show hatred towards one another. This is emphasized by the Quran since the beginning of his revelation: *"O people! We have created you from a male and a female, and have made you peoples and tribes so that you may know one another."* [Capt. Al-Hujurat: 13]

The Qur'an and the Prophetic Tradition (Sunnah) are the main sources of Islamic religion, and both with their norms and rules deal with the issue of tolerance and religious freedom and freedom of expression.

I think that the tolerance of a religion is a criterion of its vitality. The more noble the provisions of a religion, the greater will be its predispositions to become universal religion, the religion of the human race.

Keywords: Quran, tradition, tolerance, muslim, proponents of the book.

TOLERANCA NË KUR'AN

Fillimisht mund të citojmë një ajet kur'anor, që është parim themelor i besimit islam dhe dispozita më madhështore me të cilën theksohet liria e plotë e besimit: *"Nuk ka dhunë në fe."*⁸¹

Në një vend tjetër, Kur'ani thekson qartë, se zgjidhja përfundimtare e besimit është çështje private, vetjake: *"Thuaj: E Vërteta është nga Zoti juaj, prandaj kush do, le të besojë, kush do, le të mos besojë."*⁸²

Vargu i mëposhtëm kur'anor e bën edhe më të qartë parimin e lirisë së besimit, apo të mosbesimit individual.

*"Thuaj: O ju mosbesimtarë! Unë nuk adhuroj atë që ju e adhuron. As ju nuk adhuron atë që adhuroj unë. Unë kurrë nuk do të jem adhurues i asaj që ju adhuron. Ju keni fenë tuaj, unë kam fenë time."*⁸³

Ky koncept i tolerancës ndaj besimeve të tjera shtrihet edhe më tej dhe Kur'ani përkufizon qartë rolin dhe kufijtë e profetësisë. Kur'ani i porosit muslimanët të jenë tolerantë, zemërgjerë, të mëshirshëm dhe komunikues me pjesëtarët e feve të tjera: *"Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi, këshillime, të mira dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë."*⁸⁴

Kur'ani nga muslimanët jo vetëm që kërkon tolerancë, mirëkuptim, sjellje e qëndrim korrekt ndaj pjesëtarëve të feve të tjera, por ai shkon edhe më larg dhe nga toleranca kalon në shkallën e njohjes, që është shkalla më e lartë e tolerancës dhe garanci për bashkëjetesë. Judaizmin dhe krishtërimin i njeh si fe monoteiste, fe që kanë librat e tyre të shpallur nga Zoti dhe bashkë me Islamin, që te tre religjionet, i quan fe qiellore, ndërsa hebrenjtë dhe të krishterët, si "Ehlu'l-Kitab – Ithtarë të Librit"

Në favor të asaj që Kur'ani i njeh popujt e tjerë shkon edhe njohja e profetëve të tyre. Kur'ani në të vërtetë nuk bën kurrfarë dallimi në mes të profetëve, duke filluar prej Ademit (Adamit) nëpërmjet Ibrahimit (Abrahamit) e Musait (Moisiut) e deri tek Muhamedi (a.s.). Ndërsa për Isain (Jezusin) – të birin e Merjemes (Marisë), vërtetues i Teuratit (Toras), thotë:

⁸¹ Kur'an, El-Bekare :256.

⁸² Kur'an, El-Kehf : 29.

⁸³ Kur'an, El-Kafirun : 1-6.

⁸⁴ Kur'an, En-Nahël : 125.

Thirteenth International Scientific Conference
THE TEACHER OF THE FUTURE
25-28.5.2017, Budva, Montenegro

“Ne dërguam në gjurmët e profetëve – Isain (Jezusin). Dhe ne i dhamë atij Inxhilin (Ungjillin), në të cilin ka udhëzime e dritë, vërtetues i Tëvratit (Toras), të cilin e kanë para vetes – udhërrëfim dhe këshillim për ata që i druhen Zotit.”⁸⁵

Kur’ani flet mbi Jezusin (Isain) në mënyra që nuk shprehen as për Muhamedin (a.s.). Jezusi është quajtur Abdullah (rob, shërbëtor i Zotit) dhe në Kur’an kalon si “minel mukarrabin” (ai që është afër Zotit), kurse Maria (Merjemja) citohet 34 herë në Kur’an, ndërsa në Besëlidhjen e Re, 19 herë. Merjem është e vetmja grua e thirrur me emrin e saj në librin e shenjtë, duke marrë emrin edhe një prej kapitujve të Kur’anit.⁸⁶

TOLERANCA NË TRADITËN PROFETIKE

Një prej shembujve më interesant i tolerancës së Profetit Muhamed është statuti i privilegjeve të të krishterëve dhënë nga Profeti për murgjërit e Manastirit të Shën Katerinës. Në vitin 628, Profeti Muhamed garanoi një Statut privilegjesh për murgjërit e Manastirit të Shën Katerinës në Malin Sinai. Ai përbëhej nga disa klauzola të cilat mbulonin të gjitha aspektet e të drejtave të njeriut, përfshirë këtu tema të tilla si, mbrojtja e të krishterëve, liria e adhurimit dhe lëvizjes, liria për të caktuar gjykatësit e tyre dhe për të patur dhe mbajtur pronat e tyre, përjashtimi nga shërbimi ushtarak dhe e drejta e mbrojtjes në kohë lufte.

“Ky është një mesazh nga Muhamedi, biri i Allahut, si një pakt për ata që mbajnë Krishtërimin, pranë dhe larg, ne jemi me ta. Metëvërtetë unë, shërbëtorët, ndihmuesit dhe ndjekësit e mi, i mbrojnë ata, sepse të krishterët janë qytetarët e mi, dhe për All-llah, unë jam gjithmonë kundër çdo gjëje që i dëshpëron ata...”⁸⁷

Ky statut i privilegjeve ka qenë nderuar dhe zbatuar me besim të plotë nga gjithë muslimanët nëpër shekuj dhe nëpër të gjithë tokat ku ata sunduan.

Profeti Muhamed si komentator legjitim i Kur’anit, i shpjegoi më gjerësisht parimet dhe idealet kur’anore për tolerancën dhe lirinë e besimit dhe me shembullin e vet vuri në jetë dhe i bëri traditë praktike edhe për brezat pasardhës. Duke i quajtur hebrenjtë dhe të krishterët “Dhimijj – të mbrojturit”, d.t.th. ata që shteti islam e ka për detyrë t’i mbrojë, Profeti tha:

“Kush torturon një dhimijj, unë jam armik i tij dhe atë armiqësi do ta shfaq edhe në Ditën e Gjykimit”.

Në një letër që ua dërgon hebrenjve dhe të krishterëve të Nexhranit, Profeti thotë:

“Nexhrani dhe fqinjësia e tij, nga Zoti dhe profeti i Tij Muhamed e kanë të mbrojtur – pasurinë e tyre, kishat e tyre dhe gjithçka që kanë në pronësi”.⁸⁸

Fjalimi i njohur lamtumirës i Profetit i ka përmbledhur mësimet islame për veprimet e qarta e të drejta ndaj njerëzve, më vonë ajo do të bëhet një deklaratë e paprecedentë për të drejtat e njeriut. Gjatë kohës së Haxhit të fundit (Pelegrinazhit islam) dhe pak para se të ndërrohej jetë Profeti tha:

“O ju njerëz, ju keni një krijues dhe një të parë. Të gjithë jeni pasardhësit e Ademit, e Ademi është prej dheut. Nuk është i pranueshëm kurrfarë dallimi në mes jush. Nuk ka përparësi arabi ndaj joarabit, as joarabi ndaj arabit! I bardhi nuk është më i mirë se i ziu, as i ziu më i mirë se i bardhi. E vetmja gjë e rëndësishme është devotshmëria personale...”⁸⁹

Janë pikërisht këto fjalë që themelojnë kushtetutën islame e cila ndalon gjakmarrjen, racizmin, padrejtësinë dhe dhunën.

TË DREJTAT E JOMUSLIMANËVE NË SHOQËRINË ISLAME

Për sa i përket përcaktimit të drejtave të jo muslimanëve, Kur’ani Famëllartë në mënyrë eksplicite e manifeston respektin që ka ndaj jo muslimanit brenda sistemit Islam, ku prek ndjenjat e tyre duke kërkuar që edhe debati me to të realizohet në formën më demokratike dhe më të mirë që është e mundur:

⁸⁵ Kur’an, El-Maide : 46-47.

⁸⁶ Michel, Th., Për të kuptuar kristianizmin: Një i krishterë i paraqet muslimanëve fenë e tij, isg edizioni, pa vit botimi, Tiranë, f. 43-45.

⁸⁷ Kruja, Genti, “Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërjetar”, Prizmi, Tiranë, 2008: 116; Zahur, Dr. A.; Hak, Dr. Z., gazeta Drita Islame.

⁸⁸ Grup autorësh, libri “Simpoziumi Ndërkombëtar-Profeti Muhamed-Mëshira dhe dashuria universale”, Botimet KMSH, Tiranë, 2007: 109.

⁸⁹ Ramiq, Dr. J., “Hutbe të zgjedhura të Muhamedit (s.a.s.)”, Botimet KMSH, Tiranë, 2008: 100.

Thirteenth International Scientific Conference
THE TEACHER OF THE FUTURE
25-28.5.2017, Budva, Montenegro

*"Ithtarët e librit mos i polemizoni ndryshe (kurrë i thirrni në fenë tuaj) vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë dhe thuajuni: "Ne i besuam asaj që na u zbrit neve dhe që u zbriti juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij"*⁹⁰

Respektimi që Krijuesi i dhuroi njeriut ndaj krijesave tjera madje i sugjeroi muslimanët që në asnjë mënyrë mos t'i fyejë zotrat të cilët i besojnë politeistët, që kjo mos i motivoi ata që të fyejnë Krijuesin e vërtetë. Nuk ka dyshim se në këtë ka respekt ndaj njeriut. Të respektosh ndjenjat e tjetrit që ka ndaj kulteve të tij të shenjta është nder dhe respekt i veçant. Sikur muslimanët të fyenin zotrat e politeistëve, edhe politeistët do të fyenin Zotin e besimtarëve dhe kjo do të ishte gjenerator i urrejtjeve dhe konflikteve mes tyre. I Plotëfuqishmi në Kur'an na rekomandon që të mos i fyejm zotrat e tyre edhe pse nuk janë real:

*"Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët), pos All-llahut, e (si hakmarrje) të fyejnë All-llahun nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij). Kështu Ne ia kemi zbukuruar çdo populli veprimin e vet, mandej e ardhmja e tyre është te Zoti i tyre, e Ai i shpërblen për atë që vepruan"*⁹¹

Nga etika e lartë e profetit Muhamedit është se ai i çmonte të gjithë njerëzit. Nisur nga ky princip i tij ai i respektonte të gjithë vëllezërit e tij profet dhe të njëjtët i lëvdonte. Për Isën a.s. do të thotë: *"Unë jam më pranë Isaut a.s në këtë dhe në botën tjetër. Të gjithë profetët janë vëllezër. Kan lindur prej nënave të ndryshme por kanë një fe."*

Për respektin që kishte ndaj Musaut a.s, kur emigroi prej Meke në Medinë, i gjeti çifutë duke agjëruar ditën e Ashurasë. U tha: *"Çka është kjo? Thanë: kjo është dita që shpëtoi Salihu, kjo është dita në të cilën All-llahu i shpëtoi bijtë e Izraelit nga armiqët e tyre, ndërkaq Musai agjëroi."* Profeti Muhamed tha: *"Unë jam më pranë Musait se ju dhe agjëroi, duke urdhëruar besimtarët për agjërimin e tyre."*

Ky njëherit është edhe qëndrimi i muslimanëve. I respektojnë të gjithë profetët e All-llahut. Një sjellje e tillë do të shtoi në fisnikërinë e pasuesëve të atyre profetëve.

Një nga insertet që e portretizon nderimin e njeriut në Islam, është edhe rasti kur Muhammedi a.s, i urdhëroi besimtarët që ishin të pranishëm që të ngritjen në këmbë gjatë kalimit të një kortezhi. Të pranishmit iu drejtuan të deleguarit të Zotit me këto fjalë: *"Ajo është kufomë e një çifutit!? Pejgamberi a.s u tha: "A nuk ishte njeri!?"*⁹²

Respekti ndaj jo muslimanëve nuk përfundoi me profetin Muhamed, por ky trend vazhdoi edhe më pas, gjatë kohës së udhëheqësve të drejtë dhe se ky trend i respektimit do të vazhdoi deri sa të ekzistoi gjithësia.

E DREJTA E BESIMIT

Liria fetare është e drejtë e çdo individi të cilën Islami e ka proklamuar që në ditët e para të tij. Islami nuk i detyron oponentët e tij që ta përqafojnë atë me presion. Farre nuk mban teza se Islami është përhapur me dhunë kur dimë se kjo është e pa pranuar sipas konceptit Islam. Por një thënie e tillë nuk është e rastësishme; ajo ka qëllimet e saja. Kjo shpifje bëhet për të ushtuar dhunë psikike mbi myslimanët dhe për të zbehur atë para opinionit botërorë. Megjithatë, këtë thënie nuk e pranon logjika e shëndoshë ngase nuk korrespondon me realitetin e Kur'anit edhe me praktikën e Muhammedit (a.s).

All-llahu Fuqplotë të dërguarit të Tij i thotë: *"Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t'i besonin çka janë në tokë që të gjithë. A ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?"*⁹³

Duke marr në konsideratë këtë ajet, profeti Muhamed njerëzit do t'i lej të lirë që të zgjedhin në mes përqaimit të Islamit apo të mbeten në fenë e tyre. Duke kuptuar se lufta kundër Islamit do të zhvillohet në kontiunitet, i Dërguari i Zotit që të mos lejë vakum do të lidh marrëveshje me jomuslimanët, duke ua garantuar të drejtat e tyre fetare, dhe se pasuria, gjaku, nderi i tyre, është i garantuar. Kjo do të jetë edhe arsyeja që ata të gëzojnë epitetin (ehlu dhime- të mbrojtur). Ky sugjerim i Pejgamberit (a.s) vjen si rezultat i fjalës së All-llahut: *"Në fe nuk ka dhunë"*⁹⁴

Në lidhje me këtë ajet profesori i shquar amerikan Edvin Kolgërl deklaroi: *"Në Kur'an ekziston ajet të cilin e dinë që të gjithë muslimanët e cila manifeston sinqeritetin dhe urtësinë, dhe këtë duhet ta dinë edhe të tjerët, e ajo është "Në fe nuk ka dhunë."*

⁹⁰ Kur'an, El-Ankebut : 46.

⁹¹ Kur'an, El-En'am : 108.

⁹² Sahihul Buhari, vëll. II, fq. 86 .

⁹³ Kur'an, Junus : 99.

⁹⁴ Kur'an, El Bekare : 256.

Thirteenth International Scientific Conference
THE TEACHER OF THE FUTURE
25-28.5.2017, Budva, Montenegro

Ky ajet ka zbritur si shkak i disa ensarëve, bijtë e të cilëve konvertoheshin në të krishterë ose në të çifutë. Kur u paraqit Islam prindërit e tyre tentonin që t'i detyrojnë ata në pranimin e Islamit. Zbret ajeti në fjalë, i cili ua ndalon një veprim të tillë.⁹⁵

Nëse analizojmë këtë ajet si dhe arsyen e zbritjes së tij, do të arrijmë të kuptojmë se nuk lejohet detyrimi i dikujt që të përqafojë Islamin qoftë detyruesi të jetë edhe prindi që ia dëshiron të mirën fëmijës.

Kur Mbreti El-Mensur në vitin 680 h. do të gjykoj që jomuslimanët të pranojnë Islamin, ata besuat dhunshëm. Në lidhje me këtë vendim të tij u hidhëruan dijetarët Islam dhe do ta quajnë si gjykim të shpejtuar. Pas gjashtë muajsh dijetarët mbajtën një seancë plenare dhe dolën me një qëndrim të përbashkët se, ata të cilët e kanë pranuar Islamin kanë qenë të detyruar dhe të njëjtin nuk e kanë pranuar me dëshirë. Sipas rregullave fetare nuk duhet detyrim për hyrje në fe dhe u takon që t'i kthehen fesë së tyre, dhe shumica prej tyre iu kthyen fesë së më parshme.⁹⁶

DËSHMI TË JOMUSLIMANËVE PËR TOLERANCËN ISLAME!

Doktoresha Italiane, Lora Vitsha Veljiri thotë: “Muslimanët bënin marrëveshje me popujt tjerë që njerëzit t'i lënë të lirë në çështjen e besimit. Nuk ushtronin kurrfarë presioni ndaj popullatës që ata me çdo kusht të pranojnë fenë e re. Ushtria Islame nuk ndiqeshete nga misionarë që t'i detyrojnë në pranimin e Islamit – ata që akoma nuk e kishin pranuar atë. Misionarët nuk ishin në epiqendër e as që dalloheshin me metoda që të përhapin fenë e tyre apo të dalin në mbrojtje të tij. Jo vetëm kjo, por gjatë një periudhe të gjatë muslimanët obligoheshin që çdo secili që hyjë në Islam që të mos përdoret dhe të agjitoj në përhapjen e Islamit. Nga përqafoesit e Islamit kërkoheshin që të dalin dhe të dëshmojnë para gjykatës dhe të proklamojnë në mënyrë publike se Islami i tyre nuk është si rezultat i ndonjë trysnie apo dhune të ushtruar. Madje, me pranimin e Islamit nuk ka për qëllim përfitimi material apo të ndonjë nominimi në ndonjë pozicion.”⁹⁷

Nuk është e mjaftueshme që popullata të lehet vetëm që të besojë, por toleranca e të drejtës Islam shkon edhe më larg, përpos që jo muslimanët të kenë të drejtë të aplikojnë ritet e tyre, monumentet dhe manastiret e tyre, ata duhet të mbrohen nga shteti:

“(U lejuan të luftojnë) Ata, të cilët vetëm pse thanë: "All-llahu është Zoti ynë!" u dëbuan prej shtëpive të tyre pa kurrfarë të drejte. E sikur All-llahu të mos i zbrapste disa me disa të tjerë, do të rrënoheshin manastiret, kishat, havrat e edhe xhamitë që në to përmendet shumë emri i All-llahut. E All-llahu patjetër do ta ndihmojë atë që ndihmon rrugën e Tij, se All-llahu është shumë i fuqishëm dhe gjithnjë triumfues.”⁹⁸

Tolerancën e muslimanëve ndaj pakicave jo islame do ta dëshmojnë edhe shumë perëndimorë, ndër to Gustav Leboni i cili thotë:

“Toleranca e profetit Muhamedit ndaj çifutëve dhe të krishterëve ishte shumë e madhe. Atij nuk i ngjasoi asnjëri nga themeluesit e feve që u paraqitën para tij, në veçanti çifutizmi apo krishterimi. Hulefatë e ndoqën Sunnetin- rrugën e tij. Këtë tolerancë e njohën disa nga shkencëtarët perëndimorë dhe ca besimtarë të cilët u begatuan me hulumtimin në historinë e arabëve.”⁹⁹

Muslimanët e kanë për obligim fetar që t'i mbrojnë monumentet e fetare të të tjerëve dhe assesit nuk kanë të drejtë t'i dëmtojnë të cilin realitet e dëshmon patriku Nesturiu Jav i III-të në shkresën që ia dërgon Seman Miteran Rifardshir dhe kryetarë i katedrales Persiane ku thuhej:

“Arabët të cilëve Zoti ua mundësoi të sundojnë me tërë botën dëshmojnë në atë që u trajtojnë e ju jeni në mesin e tyre . Gjë të cilën ju e dini shumë mirë . Ata nuk e luftojnë religjioni krishterë, por në të kundërtën ata janë të kujdesshëm dhe i respektojnë murgjit tanë dhe kanë respekt të veçantë ndaj manastireve.”

Manastiret e lindjes në Azi ishin të ndara dhe shumë larg nga bota e krishterë ku nuk kishte kush në botë t'u u qëndrojnë për krahu, duke patur në konsideratë si grup jasht nga feja. Vetë ekzistimi i këtyre kishave deri më sot është argument i fuqishëm që dëshmon mbështetjen politike të qeverisjes islame në përgjithësi dhe toleranca e paparë e tij.

Jomuslimanët përjetuan liri që nuk e hasnin tek grupacionet tjera jashtë fesë së tyre. Mu edhe ky do të jetë preteksti krishterët në Sham t'i dërgojnë shkresë Ebi Ubejde bin El-Xherah (r.a), i cili atë kohë ishte udhëheqës i ushtrisë muslimane dhe ishte ushtarak i dalluar, në çlirimin e Shamit. Në mes tjerash thonin: “O musliman, ju për ne

⁹⁵ El Vahidiu, *Esbabun-Nuzul* , 114- 116 .

⁹⁶ *El-Bidaje ven-Nihaje*, vëll. XVII, 573- 578 .

⁹⁷ Defai anil Islam, 35-36 .

⁹⁸ Kur'an, El-Haxh : 40.

⁹⁹ Hadaretu-l-arab , 128 .

Thirteenth International Scientific Conference
THE TEACHER OF THE FUTURE
25-28.5.2017, Budva, Montenegro

jeni më të dashur se bizantinët (romakët) edhe pse ata i takojnë fesë tonë. Ju jeni më të sjellshëm dhe më besatarë se ata ngase nuk ushtroni dhunës ndaj nesh. Udhëhiqni më mirë me ne. Ata na ngadhënjyen neve dhe na i konfiskuan shtëpitë tona.”¹⁰⁰

Tomas Arnoldi në veprën e tij (Thirrja në Islam) potencon se në Itali kishte masë që mallëngjeheshin për turqit. Ata e përkujtonin kohën që gëzonin liri dhe tolerancë që nuk e kishin përjetuar kur ishin nën hijen e qeverisë krishtere. Banorët e bizantit shpesh e përmendnin thënien e një udhëheqësi fetar të tyre: “Për ne më mirë në qytetin tonë është të shohim kapuçin turk se sa të shohim kurorën e papës.”¹⁰¹

Duke përkujtuar Arnoldi se ajo që ngjau me dëbimin e çifutëve spanjoll në logoret, u drejtuan drejtë Turqisë në fund të shek. XV.

Është e udhës të potencohet se mbetja e jomuslimanëve në fenë e tyre shekuj me radhë në Sham, Egjipt, Andolus, është argument i qartë që fletë për tolerancën fetare edhe pse kjo tolerancë do të çoi në shlyerjen e Islamit në disa vende siç Andalusia.

Kant Hanri di Kastri thotë: “Toleranca dhe butësia e muslimanëve ishin pretekst i ramjes së mbretërisë arabe.”

LIDHJA DHE VLERSIMI NJERËZOR

Megjithëse lidhja e besimit dhe vëllazëria e fesë është lidhja më e lartë, megjithatë, ekziston edhe një lidhje dhe një lloj vëllazërie tjetër, asaj njerëzore që i përfshin të gjithë njerëzit, muslimanët dhe jomuslimanët. Ne shikojmë se shumë ajete të Kur’anit fillojnë me fjalët: “O ju njerëz” dhe jo me “O ju që keni besuar”.

Këto ajete zakonisht kanë të bëjnë me lidhjet e mëdha njerëzore, pa marrë parasysh anën e besimit. Si shembull për këtë përmendim ajetin ku All-llahu Fuqiptotë thotë:

*“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqën) e saj”*¹⁰²

Vlerësimi i njeriut thjesht dhe vetëm se është njeri, ku në Kur’an thuhet: “Ne vërtet i nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit)”¹⁰³

Ky verset na tregon se të respektuar dhe të nderuar janë të gjithë njerëzit, qofshin muslimanë ose jo. Një prej treguesve të këtij nderimi është edhe shenjtërimi i gjakut të njeriut, i nderit, dhe i pasurisë së tij. “Për këtë (shkak të atij krimi) Ne u shpallëm (ligj) beni israilëve se kush vret një njeri (pa të drejtë), pa pasë vrarë ai ndonjë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t’i kishte vrarë gjithë njerëzit. E kush e ngjall (bëhet shkak që të jetë ai gjallë) është si t’i kishte ngjallur (shpëtuar) të gjithë njerëzit”¹⁰⁴

Njeriu që përmendet në këtë ajet është çdo njeri në përgjithësi dhe nuk është i kufizuar vetëm për besimtarët. Të njëjtin term ka përdorur edhe Profeti i Zotit kur u ngrit në këmbë kur pranë tij kaloi kortezhi i një çifuti, dhe kur i treguan se ajo ishte kortezhi i një çifuti, ai u përgjigj duke thënë: “A nuk është edhe ai një shpirt (njeri)?!” (Transmetohet nga Buhariu).

EVITIMI I FANATIZMIT FETAR

Largimi dhe braktisja e fanatizmit fetar duke vënë theksin në unitetin dhe njësimin e mesazhit të të gjithë profetëve, duke pranuar në të njëjtën kohë edhe të gjithë profetët e Zotit, duke besuar tek ata dhe tek shpalljet që u zbritën mbi ta. Në Kur’an thuhet: “Ai ju përcaktoi juve për fe atë që ia pat përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të”¹⁰⁵

Pikërisht për këtë arsye nuk ka asnjë shkak apo arsye për luftëra fetare ku pasuesit e një profeti të luftojnë kundër pasuesve të një profeti tjetër edhe pse muslimanët besojnë se islami është feja përmbyllëse dhe shfuqizuese e të gjitha feve dhe ligjeve që kanë qenë përpara tij. Kur’ani i fton ithtarët e librave hyjnorë në veçanti për të gjetur gjërat e përbashkëta mes nesh dhe mes tyre. “Thuaju (o i dërguar): “O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të

¹⁰⁰ Dr. Ahmed Muhamed El-Hufi, *Semahatul Islam*, 57.

¹⁰¹ Nourman Pitz, *Imperatoria Bizantine*, 391.

¹⁰² Kur’an, En Nisa : 1

¹⁰³ Kur’an, El Isra : 70

¹⁰⁴ Kur’an, El Maide : 32

¹⁰⁵ Kur’an, Esh Shura 13

Thirteenth International Scientific Conference
THE TEACHER OF THE FUTURE
25-28.5.2017, Budva, Montenegro

*bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, pos All-llahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos e konsiderojmë njëri - tjetrin zotër pos All-llahut”!*¹⁰⁶

Po nëse ata refuzojnë çfarë duhet të bëjmë? Pjesa tjetër e ajetit nuk thotë që t'i luftoni, as t'i trajtoni me ashpërsi dhe vrazhdësi, por thotë: “E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: “Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë (besuam një Zot)”!¹⁰⁷

RAPORTI I MUSLIMANIT ME JOMUSLIMANËT

Marrdhëniet e muslimanit me jomuslimanët në bazën e tyre kanë mirësinë dhe drejtësinë për sa kohë ata janë paqësorë ndaj tyre. Kjo gjë tregohet qartë në ajetin e Kuranit ku Allahu xh.sh. thotë: “*All-llahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; All-llahu i do ata që mbajnë drejtësinë. All-llahu ua ndalon t’u afroheni vetëm atyre që ju luftuan për shkak të fesë, që ju nxorën prej shtëpive tuaja dhe që ndihmuan në dëbimin tuaj; ju ndalon të miqësoheni me ta. Kush miqësohet me ta, të tillët janë dëmtues të vetvetes”* (El Mumtehine 8-9)

Ajo që të tërheq vëmendjen në këtë ajet është cilësimi i marrëdhënieve mes tyre më fjalën “bir-r (gj.ar) – të bëni mirë”. Ajo jo vetëm që është grada më e lartë e moralit të mirë, por gjithashtu ajo dhe fjalët që rrjedhin prej saj, në Kur’anin fisnik dhe në citatat profetike janë përdorur për të cilësuar marrëdhëniet e muslimanit me prindërit e tij që është një lidhje që përfshin mëshirën, respektin dhe trajtimin e mirë. Përdorimi i fjalës “teber-ruhum” në veçanti e përmban këtë domethënie. Përdorimi i saj nuk është i rastësishëm sepse Krijuesi mund të kishte përdorur shumë fjalë dhe shprehje të tjera që tregojnë marrëdhënie të mira.

Ky lloj cilësimi është në përputhje të plotë me cilësimin e mesazhit të islamit si “mëshirë për të gjitha botërat”. Për sa i përket fjalisë që në ajet përdoret “*All-llahu i do ata që mbajnë drejtësinë.*”, komentatori Kurtubi thotë për të: “Pra, tu jepni atyre një pjesë të pasurisë tuaj për t’i respektuar dhe për të mbajtur lidhjet. Këtu nuk ka për qëllim drejtësinë sepse drejtësia është një detyrim si ndaj atyre që janë paqësorë ashtu edhe ndaj atyre që tregohen armiqësorë”¹⁰⁸

Kur’ani i fton muslimanët që të dialogojnë paqësisht me ithtarët e librit në veçanti për të vënë theksin në pikat e përbashkëta mes tyre. I Lartësuar thotë: “*Ithtarët e librit mos i polemizoni ndryshe (kurr i thirrni në fenë tuaj) vetëm ashtu si është më së miri, përveç atyre që janë mizorë dhe thuajuni: “Ne i besuam asaj që na u zbriti neve dhe që u zbriti juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij”* (El Ankebut 46)

Kur’ani është ai që na fton për këtë edhe pse vetë ai na tregon dallime të rëndësishme që kanë lidhje me atë që u ka ndodhur librave hyjnorë të mëparshëm që nga koha kur kanë zbritur mbi profetët e tyre. Po ashtu edhe për disa çështje bazë rreth besimit në Zotin, në emrat dhe në cilësitë e Tij. Kjo gjë tregon qartë se Kur’ani edhe pse na i tregon këto ndryshime të rëndësishme, megjithatë i nxit muslimanët që t’i zbulojnë dhe t’i kuptojnë gjërat e përbashkëta mes tyre dhe ithtarëve të librit, për të përfutur për mbajtjen e lidhjeve me ta, madje për të bashkëpunuar me ta për mirësi dhe devotshmëri aty ku nuk bie në kundërshtim me rregullat e islamit.

Prej çështjeve të përbashkëta janë: besimi në Zot, në profecitë, në revelat, në librat hyjnorë, në ditën e fundit, në vlerat morale, paqja, drejtësia, dashuria për njerëzit, kujdesi për kafshët, mbrojtja e ambjentit, etj.

TË BARABARTË PARA LIGJIT

Islami na fton që të tregohemi të drejtë edhe me kundërshtarët. Sjellja jo e mirë ndaj jomuslimanëve nuk është e drejtë, madje as përgjigja ndaj mirësisë së tyre përveç se me të mirë.

All-llahu Fuqiptotë thotë: “*A mund të jetë shpërblimi i veprës së mirë diçka tjetër, përveç të mirës!*”¹⁰⁹

Aplikimi i obligimeve fetare të jomuslimanëve të parapara është nga të drejtat themelore të jomuslimanëve që jetojnë në trojet islame.

Nga toleranca e islamit është se nuk i detyron jomuslimanët t’u nënshtrohen normave të legjislacionit islam. Ata janë të liruar nga taksa fetare (Zeqati) që është nga shtyllat Islame.

¹⁰⁶ Kur’an, Ali Imran : 64

¹⁰⁷ Kur’an, Ali Imran : 64

¹⁰⁸ Shiko “Përmbledhje e rregullave të Kuranit” të Kurtubiut, shtëpia botuese ”Ringjallja e trashëgimisë arabe”, Bejrut 1966, vëllimi i 17, faqe 59.

¹⁰⁹ Er Rrahman : 60.

Thirteenth International Scientific Conference
THE TEACHER OF THE FUTURE
25-28.5.2017, Budva, Montenegro

Jomuslimanët janë të lirë nga shërbimi ushtarak, nga e cila nuk përfitojnë vetëm muslimanët por edhe të tjerët nga banorët e shtetit Islam. Arseye e mos obligimit është se ata paguajnë tatimin financiar i cili është i lehtë si kundërvlerë e kësaj falje e cila në Islam njihet me *“el- xhizje”*.

Ms. Tomas Arnold thotë: “Kjo taks ishte e thjeshtë dhe nuk ishte vështirë për tu paguar, kur kemi para sysh lirim të tyre nga shërbimi ushtarak i cili ishte obligim i detyruar për bashkatdhetarët e tyre musliman.”

Religjioni Islam me tolerancën e tij do të shkoi edhe më larg, ku jomuslimanët u njihet e drejta që në jetën e tyre të aplikojnë të drejtën e tyre civile, penale të bazuar në të drejtën e tyre fetare edhe pse jetojnë brenda trojeve islame.

Duke marr në konsiderat këta parime, jomuslimanët kishin gjykatësit e tyre, mirëpo të shumtë ishin rastet ku për gjykim u orientoheshin muslimanëve dhe gjykoreshin sipas ligjit Islam. Nëse kërkesa u orientohej gjykatësve islam, në konsiderat vjen drejtësia. All-llahu xh.sh. i drejtohet të dërguarit të Tij: *“Në qoftë se vijnë te ti (për ndonjë gjykim), gjyko mes tyre ose hiqju tyre. Nëse prapsesh prej tyre (nuk gjykon), ata nuk mund të sjellin ty kurrfarë dëmi. Po nëse gjykon mes tyre, gjyko drejtë; All-llahu i do të drejtën”*¹¹⁰

Historiani Adam Mitz, në veprën e tij (Civilizimi Islam në shek. IV hixhrij) thotë: “Me që ligji Islam vlenë për muslimanët, udhëheqësia Islame ka themeluar gjykata për popullatën jo islame. Ajo që arrijmë të kuptojmë nga çështja e këtyre gjykatave është se ata ishin gjykata kishtarë. Kryetarët e gjykatave ishin gjykatës shpirtërorë që luanin të njëjtin rol që e luanin gjykatësit islam (kaditë).”¹¹¹

Faqet e historisë janë të shkruara me shkronja të arta që përshkruajnë drejtësinë të cilën e kanë aplikuar muslimanët ndaj jo muslimanëve.

PËRFUNDIM

Pas tërë kësaj që prezentuam arrijmë të kuptojmë se Kur’ani bën thirrje për dialog dhe marrëdhënie të mira me të gjithë pavarësisht religjinit, etnitetit që i takon. Pse jo, kur Zoti ka dialoguar edhe me më të keqen e krijesave të Tij, satanin. Për këtë arsye, ne marrin kulturën e dialogut në vend të asaj të konfliktit, si ndërmjet qytetërimeve, ashtu dhe ndërmjet feve. Mirëpo, në mesin e opinionit has praktikues ekstrem që mbështesin idenë se nuk ekziston asgjë e përbashkët mes muslimanëve dhe të tjerëve. Bëhet fjalë për një koncept krejtësisht të gabuar në lidhje me *“pasuesit e librit”*. Vallë, pse atëherë All-llahu Fuqiplotë e ka lejuar ngrënien e ushqimit të tyre dhe martesën me bijat e tyre? Pse muslimanët u trishtuan kur persianët, adhuruesit e zjarrit, korrën fitore mbi bizantinët që ishin të krishterë, pra ithtar të librit, deri ditën kur All-llahu shpalli ajetet që parathinin fitoren e afërt të bizantinëve: *“Brenda pak viteve. çështja është vendim i All-llahut, fillim e mbarim. E atë ditë besimatërt do të gëzohen për ndihmën e All-llahut. Ai ndihmon atë që do dhe Ai është i gjithëfuqishëm, mëshirues”*¹¹² Kjo do të thotë se ithtarët e librit ndonëse e mohojnë profetësinë e Muhamedi (a.s) megjithatë, janë më afër muslimanëve se sa jobesimtarët dhe idhujtarët.

Dekadat e fundit, ballafaqimet kulturore dhe etnike lanë pas vete toka të djegura e shtëpin të shkatruara, lumenj të gjakut dhe male të kufomave në mes botrave të ndryshe - të parës të dytës dhe të tretës, si rezultat i dallimit nacional, racor dhe fetar.

Sot, jo më pak se në të kaluarën, po tërbohen përleshjet e mbështetura në dallimet religjioze. Muslimanët dhe të krishterët, të krishterët dhe hebrenjtë, hebrenjtë dhe muslimanët, etj. të cilët e kanë të vështirë të ndajnë hapsirën e njëjtë shoqërore pa konflikte. Ndonse dallimi kulturor, etnik, fetar, racor është një faktor i rëndësishëm në qëndrimet tona me të tjerët, duhet ta kuptojm të gjithë se dallimi fetar, kulturor, racor, nacional është dëshirë absolute e Krijuesit, kurse ata të cilët besojn në të si Qenie absolute patjetër të mësojnë se si duhet të jetojnë në shoqëri pluraliste dhe në botën pluraliste.

Duke marrë parasysh realitetin e Maqedonis në aspektin e strukturës nacionale e konfesionale është shtet shumë nacional e shumë konfesional, atëherë duhet maksimalisht të organizohemi mbi përhapjen e mirëkuptimit dhe dialogut të mirëfilltë e konstruktiv sepse kjo është pa alternative.

Realiteti jonë është vullnet i Perendisë. Të veprosh ndryshe do të thotë ti kundërvihesh vullnetit të Krijuesit, kurse teologëve kurrsesi nuk u lejohet një veprim i tillë, mbi gjitha ata janë *“fytyra fetare”* që demonstrojnë: dashuri, tolerancë, humanitet, unitet, solidaritet – dhe natyrisht janë të distancuar nga çdo urrejtje, egoizëm, hakmarrje dhe kështu me radhë.

¹¹⁰ El - Maide : 42.

¹¹¹ El Hadaretul Islamiye fil karnir rabi el hixhrij, vëll. I, fq. 6.

¹¹² Er Rum : 4-5

Thirteenth International Scientific Conference
THE TEACHER OF THE FUTURE
25-28.5.2017, Budva, Montenegro

Por, për të erdh në shprehje veprimi konstruktiv, mirëkuptimi, toleranca dhe dialogu i mirëfilltë është parakushtë që të respektohemi në mes veti, dhe atë, duke e praktikua fenë tënde dhe duke respektua maksimalishtë fenë e të tjerëve, pa kurrfar detyrimi se pse ai i takon një nacionaliteti apo religjioni tjetër dhe me diktim ta udhëzojsh apo luftosh që të mendoj dhe besoj sikur ty.

Le të jetë dallimi në mes nesh vetëm vendi ku e bëjmë adhurimin: Xhamia, kisha, sinagoga, kur pas riteve në tokën dhe qiellin e Perëndis të gjithë jemi të barabart.

BIBLIOGRAFIA

- [1] Grup autorësh, libri “Simpoziumi Ndërkombëtar-Profeti Muhamed-Mëshira dhe dashuria universale”, Botimet KMSH, Tiranë, 2007.
- [2] Hindi, Muttaki, *Kenzu'l-Ummal*, 1981.
- [3] Hufi, Ahmed Muhamed, *Semahatul Islam*, Dar el mearif, Bejrut, 1998.
- [4] Ibn Kethir, Ismail bin Omer, *El-Bidaje ven-Nihaje*, Bejrut, 1990.
- [5] Jahja bin Adem, *Kitabu'l-Haraxh*.
- [6] KMSH, libri “Simpoziumi Ndërkombëtar-Profeti Muhamed-Mëshira dhe dashuria universale”, Botimet KMSH, Tiranë, 2007.
- [7] Kruja, Genti, “Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërjetar”, Prizmi, Tiranë, 2008.
- [8] Lebon, Gustav, *Hadaretul arab*.
- [9] Lora, Vecia Vagleri, Përktheu: Munir Balebek, *Defai anil Islam*, 1981.
- [10] Michel, Th., Për të kuptuar kristianizmin: Një i krishterë i paraqet myslimanëve fenë e tij, isg edizioni, pa vit botimi, Tiranë.
- [11] Mitz, Adem, përkthim: Muhamed Abdulhadi, *El Hadaretul Islamije fil karnir rabi el hixhrij*, Dar en neshër, Bejrut.
- [12] Ramiq, Dr. J., “Hutbe të zgjedhura të Muhamedit (s.a.s.)”, Botimet KMSH, Tiranë, 2008.
- [13] Vahidiu, *Esbabun-Nuzul*, Dar el kutub el Ilmije, 1991.
- [14] Xhanan, Ibrahim, *Diyalogun dini ve tarihi temelleri*, Isik, Stamboll, 2006.